



**PËR PUBLIKIM TË MENJËHERSHËM**

12.12.2012

Zyra për shtyp: +389 2 310 2314

Celulari: +389 (0)70 367 547

Email: [bvelickovska@usaid.gov](mailto:bvelickovska@usaid.gov)

Kontakt-informatat për projektin:

[sbasmadzieva@edc.org](mailto:sbasmadzieva@edc.org)

+389 2 3245 606 Lok.101

+389 2 3245 610 Lok.101

Celulari: +389 70 306 675

## KOMUNIKATË PËR SHTYP

### Rihapet klubi për punësim në Qendrën e punësimit Prilep

Sot është rihapur Klubi për punësim në Qendrën e punësimit Prilep, pas rinovimit dhe pajisjes së mbështetur nga Projekti Rrjeti i USAID-it për aftësitë e të rinjve për punësim (YES). Ky është një prej gjashtë klubeve të punësimit që janë rinovuar dhe pajisur në kuadër të Qendrave të punësimit në disa komuna të vendit. Përmes këtij projekti, USAID ka siguruar materiale burimore dhe libra, pajisje IT dhe mobile të reja, në vlerë totale prej 8.000 dollarëve amerikanë për secilin Klub, gjegjësisht mbi 48.000 dollarë amerikanë për të gjitha 6 klubet.

“Ne e përgëzojmë Agjencinë e punësimit Prilep për promovimin e shërbimit të ri për të rinjtë e papunësuar – punëtorja pesëditore në temë ‘Përgatitja për punë’. Shpresojmë që me rritjen e numrit të trajnerëve mes stafit të Klubit për punësim, Agjencia ta ofrojë këtë shërbim rregullisht,. Disa organizata joqeveritare e ndihmojnë realizimin e kursit interaktiv, duke e theksuar ‘mësimin përmes veprimit’” ka deklaruar Robert Wuertz, Drejtor i Misionit të USAID-it.

Qëllimi kryesor i Klubeve për punësim është mbështetja e personave të regjistruar në Agjenci, me qëllim të fitimit të aftësive të duhura për gjetjen e punësimit, në tregun e punës që ndryshon me shpejtësi të madhe në Maqedoni. Burimet dhe shërbimet e Klubeve për punësim do ta ndihmojnë edhe mësimin mbi mundësitë e karrierës dhe ndërlidhjen me diturinë, aftësitë personale dhe shkathësitë e tyre, si dhe për gjetjen e vendeve ideale të punës. Gjatë vitit të ardhshëm, Projekti USAID YES do të vazhdojë me mbështetjen e rinovimit dhe pajisjes së klubeve të punës edhe në katër komuna tjera.

#### SHËNIM PËR REDAKTORËT:

Rrjeti YES i USAID-it implementohet nga Qendra për zhvillimin e arsimit (Education Development Centre), që është qendër globale jofitimprurëse me përqëndrim në përmirësimin e procesit të mësimit dhe promovimin e shëndetit. Projekti bashkëpunon me Agjencitë e punësimit, shkollat profesionale dhe ato trajnuese, si dhe organizatat joqeveritare të përqendruara tek të rinjtë, me qëllim që t'i ndihmohet nxënësve të vitit të fundit dhe të rinjve të papunësuar përmes udhëzimit për karrierë, trajnime për aftësitë e punës dhe përvojat që mësohen gjatë punës si për shembull puna praktike dhe aktivitetet sipërmarrëse. Të gjitha aktivitetet e synojnë mbështetjen e të rinjve për të hyrë në botën e punës produktive ku shpërblehet mundi.

Që nga viti 1993, populli amerikan ka investuar mbi 500 milionë dollarë amerikanë në Maqedoni përmes USAID-it. USAID është duke punuar me popullin e Maqedonisë për krijimin e vendeve të punës, përforsimin e institucioneve dhe praktikës demokratike, avancimin e edukimit të integruar dhe përgatitjen e nxënësve për forcën e punës. Këto nisma e përkrahin tranzicionin e Maqedonisë drejt demokracisë stabile dhe prosperuese. USAID siguron ndihmë ekonomike dhe humanitare për më tepër se 100 shtete. Për më tepër informata, ju lutemi vizitoni: <http://macedonia.usaid.gov/> dhe Facebook profilin tonë në <http://www.facebook.com/USAIDMacedonia>